

KOLEC TOPALLI

LETËRSIA ARTISTIKE DHE LEKSIKU DIALEKTOR

Në kushtet e ndarjeve gjeografike, administrative e historike të shekujve të kaluar, është e natyrshme që krijohen dialekte, nëndialekte e të folme krahinore dhe në kushtet e mungesës së një gjuhe të njësuar, edhe letërsia artistike s'mund të jetë ndryshe veçse krijimtari dialektore. Çdo shkrimtar në krijimtarinë e tij ruan tiparet e së folmes së vendlindjes ose të vendbanimit. Prandaj, krahas leksikut të përbashkët, çdo shkrimtar përdor fjalë dialektore, që mund të jenë të trashëguara, të huazuara ose krijime popullore. Kjo pjesë e leksikut dialektor është një thesar më vete, që pasuron gjuhën e përbashkët, rrit efektshmërinë dhe forcën e saj shprehëse. Është detyrë e gjuhëtarëve t'i evidentojnë këto fjalë e t'i shpjegojnë deri në burimin e tyre. Është detyrë e shkrimtarëve, poetëve dhe intelektualëve të tjerë t'i shtien ato në përdorim, t'i përhapin dhe t'i integrojnë në fjalorin aktiv. Me fjalë të tilla jemi ndeshur vazhdimisht gjatë hartimit të fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe. Po paraqesim disa prej tyre.

AMË. E ka Mjedja në poemën “Liria” me kuptimin “burim”: *E vështroje ku del e lirimit ama*. Me këtë fjalë shënohet burimi i një lumi, një përroi a një rrjedhe, si edhe shtrati i lumit. Rossi e ka për it. *canale*. Përdoret edhe si abstrakt për “shkak”: *me ja gjetë amën*, që është përsëri “burim”. Është emri *amë*, i cili, përveçse “nanë”, ka marrë edhe kuptime të tjera, njëri ndër të cilët “burim jete” me përgjithësim të saj e me specializim për “burim uji”. Në nomenklaturën gjeografike njihen edhe emra lumenjsh me apelativin “nënë”, si: *Mère* në Francë, *Madre* në Spanjë. Me kuptimin “shtrat lumi” e ka Bogdani: *Drini e Buena ... gjithëherë ecin e janë ma të turbulla tue bajtunë me vetëhe plehë e baltë se kur ecinë s'amësë vet*¹.

CIRLIK. E ka Mjedja në poemën “Andrra e jetës” me kuptimin “bëjnë zhurmë”: *cirlikne rrotllat posht'e perpjjetë*. Është krijim me bazë onomatopeike, imitim i zhurmës që bëjnë rrotat kur rrotullohen. E shënon edhe Gazulli për Zadrimë, vendlindja e Mjedës.

CMAG. E ka Naim Frashëri në poemën “Bagëti e bujqësia”: *Duke këputur nga cmagu, që s'e kanë vartur mirë*. Lidhet përbrenda gjuhës me *cëmat* “pykë e vogël, hell i hollë për të qepur lëkurë, rripa, thasë etj., thumat”, e formuar nga një rrënjë **cum*, që lidhet përbrenda gjuhës me *thumb* e *thumat* “kunj druri”,

¹ Çabej SE II 39, Demiraj AE 75, Orel AED 4.

me ndërrimin *c-* : *th-* në sistemin bashkëtingëllor të shqipes. Një lidhje tjetër është me *cimak* “thimthi i bletës” e *smakth* “thumbi i grerëzës”².

DËKÓJ e ka Fishta te “Mrizi i zanave”: *Se shka vepruet, se sa diku et ju gjakun*. Del me kuptimet “derdh, rrjedh, pikon”. Shfaqet me dy forma: *dëkoj* e *dikoj*, kjo e fundit te Migjeni në “Vargjet e lira”: *një fjalë të rëndë mendonte / botës t’i a dikonte*. Kuptimi i parë ka qenë “rrjedh, pikon”, në të folme popullore: *po dikon shi, po dikon breshën*. Fjalë me burim onomatopeik, imitim i tingullit të pikës që bie (*tik-tik*), me kthimin e bashkëtingëllores së shurdhët në të zëshme në një rrokje të patheksuar, si te *dëshmoj* nga lat. *testimoniāre*³.

DËNESË. E ka Fishta te “Mrizi i zanave” me kuptimin “qarje me ngashërim, gulçim”: *M’e lânë me dnesë prap nen kambë t’huej t’poshtnueme*. Mjedja e përdor si folje te “Vaji i bylbylit”: *Tui dnes’ i vorfni se e mbluene t’kijat*. Është formim i brendshëm me parashtesën *dë-*, rrënjën *ne-* dhe prapashtesën *-së*. Rrënja *ne* është emri *nye*, që në trajtën e shquar dhe në shumës del me zanoren *-e* (*neu, neje*), që përlligjet prej shprehjeve: *nuk më shkon buka, m’asht lidhë nye; iu lidh një nyjë në grykë (nga ngashërimi)*. Dënësja është një vaj me ndërprerje, sikur ndesh në një pengesë, në një nyjë (khs. edhe *nyja e fytit*)⁴.

E VДАРË. E ka Poradeci në poezinë “Naim Frashërit” në vëllimin “Vallja e yjve” me kuptimin “e humbur”: *Gjuh’ e ëmbël e stërgjyshve do të dukej gjuh’ e vdarë*. Lidhet brenda gjuhës me foljen *bjerr* “humb” nga ie. *b^hero*, me apofoni kualitative *-e* ~ *-o-*, që në gjuhën shqipe ka dhënë *-je-* ~ *-a-* dhe me parashtesën *dë-*, prej së cilës kanë dalë trajtat *dëbar, bdar, vdar*, ashtu si *dëborë, bdorë, vdorë*⁵.

FARMASON. E ka Poradeci në poezinë “Naim Frashërit” në vëllimin “Vallja e yjve”: *Prej blatishtash tradhëtije shkumbëzon një farmason*. Lidhet përbrenda gjuhës me *mason* “ndjekës i lëvizjes së fshehtë shoqërore me prirje mistike, që lindi në Europë në shek. XVIII” nga fr. *maçon* “murator”. Me këtë fjalë lidhet gegërishtja *framasû* nga it. *frammassone*, fr. *franc maçon*.

GAÇ. E ka Fishta në poemën melodramatik “Gomari i Babatasit” me kuptimin “kërriç, visk”: *Veç një gaç, një zog gomarit*. Është formim i brendshëm me prapashtesën *-ç* në një formë **gar-ç*, me zhdukje të *-r-*së para *-ç-së*. Rrënja **gar-* lidhet përbrenda gjuhës me emrin e gomarit, që te Buzuku del me formën *agër* nga **a-gar*; për gjininë femërore *gare* e *agërinjë*; te Bardhi *margaç* nga **ma-gar-ç*, në Mirditë *magar* nga *ma-gar*. Rrënja **gar-* ka burim

² Çabej SE III 24, Orel AED 47.

³ Meyer EW 65, Pedersen KZ 33, 1897, 539, Çabej SE III 218, Bonnet 252, Topalli Sist. bashk. 170.

⁴ Meyer EW 65, Kristoforidhi 79, Çabej SE III 224.

⁵ Meyer EW 70, Pedersen KZ 36, 1900, 325, Walde-Pokorny II 154, Boisacq 178, Çabej SE II 253, Demiraj AE 104, Orel AED 28, Topalli Sist. bashk. 90.

të trashëguar duke u lidhur me ie. **g^ler-* “i rëndë”, për shkak të përdorimit të kësaj kafshe për të mbajtur pesha të rënda. Me këtë rrënjë bashkohen ind. vj. *gurú-h*, gr. βαρύς, let. *grūts*, got. *kaúrjos*, lat. *gravis*, të gjitha me kuptimin “i rëndë”⁶.

GOMËN. E ka Fishta te “Lahuta e Malcis” me kuptimin “gropë në një lumë”, “pellg me ujë”: *N’ato gomna e n’ato glina*. Është huazim nga sll. *glōbina* “thellësi” me ndërrimin *-b- > -m-*. Grupi *gl-* i ballit të fjalës, që ka evoluar në *g-*, e ka burimin në geg. lindore, vatra e përhapjes së fjalës⁷. Çabej burimin e fjalës e lidh me *gop*.

I ERRMAKTË. E ka Mjedja në poezinë “I tretuni” me kuptimin “i majtë, i mëngjër”: *Nji pecë t’ kuqe i pata qepë / N’ kâmbë t’ errmaktë qi kishte repë*. Huazim nga lat. *mancus* “dorëcung, sakat”. Sipas besëtytnive të lashta, ana e majtë lidhej me të keqen, kurse e djathta me të mirën. Ka marrë parashtesën *rrë-* dhe prapashtesën *-të*. Zanorja *e-* është një protezë, që shtohet në të folme të gegërishtes veriore në fjalë që nisin me sonante në një grup bashkëtingëllor, ashtu si te Buzuku në rastet *ermonj* nga *rmoj*, *elter* nga *lter*⁸.

I RIÇËM. E ka Risto Siliqi në poemën “Mrika në shkangull”: *Më sa hapet qielli i riçëm, / s’dukesh hana, kishte ikë*. Është formim me prapashtesën *-shëm* të mbiemrave nga pjesorja *ritë* prej foljes *rîj* “lëmek, njom pakëz”. Vetë kjo lidhet përbrenda gjuhës me *i ri*, meqenëse “i ri” dhe “i njomë” janë sinonime. Një lidhje tjetër është me *resh* “bie shi a borë”, të gjitha këto nga rrënja ie. *Īer-*; për foljen *rîj* një **Iren-*, temë me bashkëtingëllore hundore⁹.

I SHUSHULLÛAR. E ka Poradeci në vëllimin “Vallja e yjve” me kuptimin “i shurdhër”: *Vesh’ i tyre i shushulluar ka timpanën e rrëxhosur*. Është formim i brendshëm nga një onomatope (*shu-shu*), imitim zhurmash, si te folja *shushurin*, *shungullon* etj.

JËTULLËZ. E ka De Rada në poemën “Milosao” me kuptimin “shirit për të lidhur flokët, kordele”: *me këshën të pjeksurith, ndë një jetullëz të bardhë*. Fjalë e arbëreshëve të Italisë, që përmban prapashtesën zvogëluese. Giordano e ka me trajtën *hjetull* dhe foljen *hjetulloj* “lidh flokët me kordele”, me grupin *hj-*, karakteristik i të folmeve arbëreshe, i cili në disa fjalë mund të jetë për *-ff-*; khs. *hjiuvull* nga it. *fiavole*. Në rrethana të tilla, *hjetull* është nga *fjetull*, me prapashtesën *-ull* prej it. *fetta* me kuptimin “rrypinë”, khs. it. *fettuccia* “shirit, kordele”.

KANÍSK. E ka Naim Frashëri në poemën “Bagëti e bujqësia”: *Mblodhe gjithë bukuritë, edhe kanisk ja ke prurë*. Del në Jug me kuptimet “peshqesh që i

⁶ Walde-Pokorny I 685, Çabej SE II 14, SE IV 235, Ashta LH I 245.

⁷ Çabej SE IV 274, Ylli SLA I 87.

⁸ Meyer EW 273, Weigand Wört. 50, Çabej SG VII 203, Orel AED 242.

⁹ Jokl Stud. 74, Walde-Pokorny II 140, Demiraj AE 346, Orel AED 371, Çabej SE VI 296.

dërgonte dhëndri nuses javën e dasmës; buka e nuses”. Huazim prej gr. së re *καβίσκι* “dhoratë”¹⁰.

KLIND. E ka Asdreni në vëllimin “Ëndra e lote”: *Vështro Kocin si po tundet / me fustanin klinda bërë*. Poradeci e ka në poezinë “Ri mbështetur në tryezë” në vëllimin “Vallja e yjve” me trajtën *kindë* me gjininë femërore: *E si fjalës së palosur / M’i hap kindën e një pale*. Përmban grupin bashkëtingëllor *kl-*, që ka evoluar në grykore të thjeshtë për shkak të zanores *-i-*. Burimi i fjalës është lat. *clino* “palë, përkulje” (khs. *inclino, -āre* “ul, përkul, kthej”), që ka marrë brenda shqipes bashkëtingëlloren *-d* si shtesë pas *-n-së*, si te emri *send*¹¹.

MBROTH. E ka Sami Frashëri me kuptimin “mbarë, përpara, mirë” te “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”. Kjo i përgjigjet gegërishtes *prodhë*, që sot është mënjeluar nga gjuha, por prej saj ka dalë folja *prodhoj*. Është huazim latino-roman: lat., it. *prode* “dobi, përfitim”. Forma *mbroth*, përkundrejt *prodhë* të gegërishtes, ka marrë protezën e një *m-je* dhe bashkëtingëllorja e zëshme fundore është shndërruar në të shurdhët për hir të pozicionit të saj, veçori e njohur e toskërishtes¹².

MEN. E ka Mjedja në poemën “Andrra e jetës” për “paksohet, pushon”: *Tirshin dhe shtojzavallet / Tui luejtë pa-mejun gishtat*. Është huazim nga it. *meno* “më pak”, prej së cilës u zhvillua një paradigmë e plotë zgjedhimi. Buzuku ka: *dittë e mī erdhnë mē porsī timi*; ku shprehja *erdhnë mē* është kalk frazeologjik sipas it. *venir meno*¹³.

MURGJINË. E ka Mjedja për një emër lope në poemën “Andrra e jetës”. *Cicé! del se erdh murgjina*. Është formim i brendshëm me prapashitesën *-inë* nga shumësi *murgj* duke u emërtuar kafsha prej ngjyrës së errët të rrobës së murgut. Trajta mashkullore është *murgjin* për “ka me qime në ngjyrë gështenje, ka i murrmë në të kuq”. Formime të tjera kësodore janë *murgjan* e *murgjar* “kalë shale, gjok”, në Tomorricë *murgjoshe* “dhi e murrme”¹⁴.

NDÓSET. E ka Fishta te “Lahuta e Malcís” me kuptimin “krejt, i tërë”: *Çelik ndoset giûni e kama*. Përdoret në Veri pas një emri për të shprehur cilësinë e tij të lartë: *qen a gomar ndoset* te Junku, Bashkimi e Cordignano, *çelik ndoset* te S. Manni. Është formim i brendshëm, rasa rrjedhore e emrit *dosë* me parashitesën *n-*, që është përdorur më së pari për dosën me dyfishim: *dosë n doset*, siç thuhet edhe sot *thi thiu, derr derri*, duke përforcuar cilësitë e kafshës me anë të përsëritjes së emrit e duke u përgjithësuar më vonë edhe për kafshë e sende të tjera me kuptimin “i tërë, krejt, plotësisht”¹⁵.

¹⁰ Çabej SE VII 254.

¹¹ La Piana AN V 1957, 17.

¹² Camarda I 75, Meyer EW 266, Orel AED 252, Çabej SE V 306.

¹³ Meyer EW 273, AS IV 77, Çabej SE V 314, Orel AED 254.

¹⁴ Stier nr. 31, Çabej SE V 383.

¹⁵ Topalli Theksi 408.

PEKÛL. E ka Naim Frashëri në poemën “Bagëti e bujqësia” me kuptimin “kujdes”: *Q’u fali Zoti të mira, u mba me shumë pekule.* Fjalë me origjinë latine-romane: lat. *peculium* “pronë e veçantë”, që rron në disa gjuhë romane (sp. *pegujal* “çiflik i vogël”, prov. *pegulhera* “pajë, prikë”, sard. *pecuiare* “pronë private”). Në gjuhën shqipe ka hyrë prej arum. *pekul’u*¹⁶.

RAKITË. E ka Lasgush Poradeci në poezinë “Zog’ i qiejve” në vëllimin “Vallja e yjve”: *E çdo lis që mban të gjelbër, e çdo pemë e çdo rakitë.* Fjalë e huazuar nga sll. *rakita* “shelg”, që nëpër dialekte ka pësuar ndërrime tingujsh duke u paraqitur me trajtat *arqitë, rrakith, ratika* etj.¹⁷.

RMAJT. E ka Fishta në vëllimin “Mrizi i zanave” me kuptimin “varr”: *E ai rmajt t’uej, atë herë, ka me kerkue.* Fjalë e huazuar, prej shumësit *romanj* (*roman* + -j), që ka depërtuar në toponimi: *Fusha e Rëmajve* “vorrezat katolike në qytetin e Shkodrës”.

RRËJ. E ka Migjeni në poezinë “Një natë pa gjumë” në vëllimin “Vargjet e lira” me kuptimin “gënjej, mashtroj”: - *Gjel rrënë a s’rrënë? Cila asht fjala e jote?* Është fjalë e trashëguar nga fondi indoeuropian. Fjalë të tilla kanë dalë zakonisht nga kuptime më konkrete, që shprehin përgjithësisht lëvizje; khs. *e luajti fjalën, e drodhi*; gjerm. *betrüegen*, që lidhet me *tragen*; lat. *erro, -āre* “endem” e “gabo”. Për fjalën e shqipes, rrënja **ren-* lidhet me got. *rann* “vrapoj”, *runs* “vrap, rrjedhë, lumë”, gjerm. *rennen* “vrapoj”. Me këtë burim, *rrëj* lidhet përbrenda gjuhës me *rrâj* “vrapoj”. Çabej burimin e fjalës e lidh me emrin *re*¹⁸.

SHPORR fol. E ka Asdreni në vëllimin “Ëndra e lote” me kuptimin “përzë a dëboj me të keq, heq qafe”: *O nxireni, të hyjë mos e lini / Të çporret! është rob e s’munt të flasë.* Formim i brendshëm nga rrënja ie. *b^her-* “sjell, mbart” me parashtesën *sh-* me kuptim privativ, që i ka dhënë fjalës kuptim të kundërt. Afrohet brenda gjuhës me *bjerr* “humbas” e *shperr* “ia humbas të gjitha”, prej së njëjtës rrënjë të trashëguar¹⁹.

SHQIM. E ka Mjedja në poezinë “Giûha shqype” me kuptimin “krejt, fare”: *T’ çon njatjë ku luftnat krisin, / Kû â kap’ Roma e Iliri shqim;* në poezinë “I tretuni”: *I falem, se shqimit / Ju m’ hiqni trishtimit.* Përdoret edhe si folje me kuptimin “shuaj, fik”, “shfaros, përfaroj”. Në disa të folme veriore del me format *shkim* (me velarizim të qiellzores); Fishta: *Me ta shkimë jeten unjî te “Lahuta”.* Për burimin e saj duhet marrë parasysh rrjedhoja *shqimëz, shkimëz* “një pjesë e prerë a e shkëputur; copë e vogël: *një shqimëz letre*”, ku del

¹⁶ Meyer EW 325, Treimer ZrPh 38, 1914, 389, Bonnet 368, Çabej SE VI 159.

¹⁷ Çabej SE II 85, Svane SLA 128, Orel AED 10, Omari MGSS 248.

¹⁸ Meyer EW 373, Pedersen KZ 33, 1897, 542, Walde-Pokorny I 78, Demiraj AE 348, Orel AED 380, Çabej SE VI 316.

¹⁹ Camarda II 152, Meyer EW 414, Jokl Stud. 84, Orel AED 431, Topalli Sist. zan. 216.

kuptimi i parë i foljes, që ka qenë “shqyej, gris, prish”, prej së cilës ka dalë “shuaj, fik”. Prandaj *shqim* e *shkim* janë formuar prej *shqyej* e *shkyej* me formantin *-m* të pjesores (*shqye* + *-m*), meqenëse pranë *shqim* ka edhe *shqym*, që del te Junku e Bashkimi. Kuptimi ndajfoljor “krejt, fare” ka dalë prej “shfaros, përfaroj”²⁰.

TRAVÁJË. E ka Mjedja në poemën “Andrra e jetës” me kuptimin “shqetësim, mundim”: *Shndritte at fëtyr’ të pa travajë*. Është huazim nga it. *travaglio* “mund, punë, vuajtje”, që e ka edhe Bogdani. Toskërishtja jugore ka *drávalla* “telashe, kokëçarje”, që ka hyrë prej gr. së re τράβαλα “mundim, zhurmë” edhe kjo me burim prej italishtes²¹.

TRIRË. E ka Mitrush Kuteli te “Ago Jakupi”: *U guros Agaj nga dhembja, kur e sull të birë nga lëmi, në trirë*. Është trajta toske e geg. *trinë* “thurimë me purteka, që përdoret për të nderë gjëra të ndryshme mbi të, argsh, branë”; huazim latino-roman: lat., it. *trīna* “thurje”²².

VDJERR. E ka Asdreni në vëllimin “Ëndra e lote” me kuptimin “humb”: *Të gjitha mplaken, vdirren po dhe treten*. Është formim i brendshëm nga *bjerr* “humb” me parashtesën *dë-*, që ka ndjekur evolucionin e fjalëve me grupin bashkëtingëllor *-db-*: *dëbjerr* > *bdjerr* (me metatezë) > *vdjerr* (me hapjen e njëres mbylltore). Të gjitha këto forma gjenden në të folme të ndryshme e tek autorët e vjetër; Buzuku: *mos bdirëtë, por të ketë gjellënë e amëshuome*; Budi: *desh qenë vdjerrë frike e tmërje* (SC); Bardhi: *Me dierrë arësynë*; lat. “obdurescere”; Bogdani: *po ende dvjerrënë shpirtinë*²³.

VOME. E ka Çajupi në përmbledhjen poetike “Këngë e vome” me kuptimin “ligje, vaj”. Formim i brendshëm nga *vaj*, por me tjetër zanore, që mund të jetë *-o-*ja hundore e labërishtes (khs. *komba* < *këmba*). Zanorja *-e* është formanti i shumësit të gjinisë femërore duke qenë fjala shumësi i singularizuar. Trajta me fundoren *-me* dalin edhe në Veri, madje mjaft herët; Budi: *eh vāj e vājme* (RR); në Tiranë: *me qā me vejme*²⁴.

ZDRALE. E ka Migjeni në “Poemën e mjerimit” me kuptimin “lerë në trup a në rroba, zhul”: *Në pijetore të qelbta, pranë tryezës plot zdrale*. Është formim i brendshëm me parashtesën *z-*, rrënjën **dra-* dhe prapashtesën *-lë*. Në geg. veriore del edhe me trajtën *zdram* me prapashtesë tjetër duke u lidhur përbrenda gjuhës me *zdramë* “plagë që i bëhet kafshës së ngarkesës kur e vret samari” dhe të gjitha këto me rrënjën ie. *der-* “rrjep, çaj”, ku bëjnë pjesë gr.

²⁰ Orel AED 433, Çabej SE VII 74.

²¹ Miklosich AF II 67, Meyer EW 435, Helbig 134, Rrota Fj. 70, Çabej SE III 305.

²² Meyer EW 437, Helbig 36, Rrota Fj. 71, Camaj AW 49, Çabej SF 2, 1966, 90, Orel AED 465.

²³ Meyer AS III 73, Camaj AW 38, Çabej SG VII 204, Orel AED 496, Topalli Fërk. 123.

²⁴ Çabej SE VII 218.

δέρω “rrjep”, δέρμα, δόρα “lëkurë”, bret. *dervoeden* “urth”, ags. *teter* “puçriza mbi lëkurë”, lit. *dedervinē* “urth”, sll. vj. kisht. *derp* “shqyej, rrjep”²⁵.

ZGAQ m. “llum, fundërri, pleh”, fig. “njeri i poshtër, pa cipë e pa nder”. E ka Mjedja: *zgaq i perbuzshem, Shqypnija t’vulli* (Juv.). Burimi i fjalës mund të dalë prej rrjedhojave: *zgaqem* “heq mbulesat, zhvishem, zbulohem”, që mund të ketë pasur në fillim kuptim pejorativ për “zbuloj trupin”; *m’u mgaqë* “m’u mbulue, m’u veshë”, që e ka Logoreci (khs. *mbuloj ~ zbuloj*). Mund të jetë formim i brendshëm prej *gaqe* “shallvare prej cohe të kaltër deri në gju”, që Xhuvani e shënon për Shkodër me kuptimin “të lintat, brekët; benevrekë të lidhura keq”; Fishta: *Nji zgobell me gaqe t’giata* (LM). Prej *gaqe*, folja *mgaqem* “mbuloj trupin me gaqe”, *zgaqem* “zhvishem, heq gaqet” me parashtesën *-z-*, që i jep fjalës kuptim të kundërt. Rrjedhoja *zgaqje* me prapashtesën *-je*.

ZGËRBONJË. E ka Mitrush Kuteli në tregimin “Ago Jakupi” me kuptimin “fyl, i gërryer”: *si një gështenjë sgërbonjë në mes të një korije të re*. Është formim me prapashtesën *-onjë* nga *zgarbë* “zgavër e madhe në trungun e një druri”, fjalë e trashëguar, e afërt me ags. *ceorfan* “pres, çallatoj”, gjerm. *Kerbe* “qokë”. Del si toponim në krahinë të Beratit. Çabej e lidh me foljen *kalb*²⁶.

Shembujt e paraqitur janë një pjesë fare e vogël e fjalëve dialektore që qëmtohen në veprat e shkrimtarëve e poetëve. Vargu i fjalëve të tilla është shumë i gjatë, meqenëse çdo shkrimtar ka shfrytëzuar pasurinë e dialektit a të krahinës për t’ia rritur vlerat veprës së tij. Prandaj, krahas vlerave artistike, veprat letrare kanë edhe vlera të mëdha gjuhësore, që lidhen me pasurinë më të madhe të një kombi dhe me trashëgimin e tij më të lashtë.

BIBLIOGRAFI

- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe*. Shkodër-Tiranë; I 1996; II 1998; III 2000; IV 2002; V 2009; VI 2012 (LH).
- Bonnet, G., *Les mots latins de l’albanais*. Paris, 1998.
- Camaj, M., *Albanische Wortbildung. Die Bildungsweise der älteren Nomina*. Albanische For-schungen, Band 6. Wiesbaden, 1966 (AW).
- Camarda, D., *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*. Livorno, 1864 (Camarda I).
- Camarda, D., *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*. Prato, 1866 (Camarda II).
- Çabej, E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Tiranë, I 1982, II 1976, III 1987, IV 1996, V 2014, VI 2002, VII 2006 (SE).
- Demiraj, B., *Albanische Etymologien*. Amsterdam, 1997 (AE).

²⁵ Orel AED 520.

²⁶ Çabej SF 3, 1968, 97, Orel AED 522.

- Helbig, R., *Die italienischen Elemente im Albanesischen*. JIRS X, Leipzig, 1903, 1-137.
- Jokl, N., *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*. Wien, 1911 (Stud.).
- Kristoforidhi, K., *Fjalor shqip-greqisht* (ribotuar prej A. Xhuvanit). Tiranë, 1961.
- La Piana, M., *Intorno ad un'antico prefisso la- nella lingua albanese*. AN V 1957, 3-21.
- Meyer, G., *Albanesische Studien*. Wien; III: Lautlehre der indogermanischen Bestand-teile des Albanesischen, 1892 (AS).
- Meyer, G., *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Strassburg, 1891.
- Miklosich, F., *Albanische Forschungen*. Wien; II: Die romanischen Elemente im Albanischen, 1870 (AF).
- Omari, A., *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*. Tiranë, 2012 (MGSS).
- Orel, V. E., *Albanian Etymological Dictionary*. Leiden, 1998 (AED).
- Pedersen, H., *Die albanesischen l-Laute*. KZ 33, 1897, 535-551.
- Pedersen, H., *Die Gutturale im Albanesischen*. KZ 36, 1900, 277-340.
- Rrota, J., *Fjalori ortografik-etimologjik; dorëshkrim*, AQSH (Fj.).
- Stier, G., *Die albanesischen Thiernamen*. KZ XI 1862, 132-150, 206-253.
- Svane, G., *Slavische Lehnwörter im Albanischen*. Acta Jutlandica 68. Humanistische reihe 67. Aarhus, 1992 (SLA).
- Topalli, K., *Theksi në gjuhën shqipe*. Tiranë, 1995 (Thek.).
- Topalli, K., *Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*. Tiranë, 2000 (Sist. zan.).
- Topalli, K., *Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe*. Tiranë, 2003 (Fërk.).
- Topalli, K., *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*. Tiranë, 2004 (Sist. bashk.).
- Treimer, K., *Albanisch und Rumänisch*. ZrPh. 38, 1914, 385-411.
- Walde, A. – Pokorny, J., *Vergleichendes Wörterbuch der indogermanischen Sprachen*, herausgegeben und be-arbeitet von J. Pokorny. Berlin - Leipzig; I 1930, II 1927, III 1932.
- Weigand, G., *Albanesisch-deutsches und deutsch-albanesisches Wörterbuch*. Leipzig, 1914 (Wört.).
- Ylli, Xh., *Das slavische Lehngut im Albanischen*; 1 Teil: Lehnwörter. München, 1997; 2 Teil: Ortsnamen. München, 2000 (SLA).

SUMMARY

ARTISTIC LITERATURE AND DIALECTAL LEXICON

Every writer in his creativity retains the features of his dialect. Therefore, besides the common vocabulary, they use dialectal words that enrich the language and increase the effectiveness of its expressive power. We present some of them: *amë* “source” (Mjedja), from *amë* “mother” and “source of water”; *cirlík* (Mjedja), an onomatopoeia; *cmag* (N. Frashëri), related to *cëmak* and *cimak*; *dëkoj* (Fishta), with onomatopoeic origin; *dënesë* (Fishta) from *dë-* + *ne-* + *-së* being connected to *nye* ~ *neu*; *e vdarë* (Poradeci) from the verb *bjerr* “lose”; *farmason* (Poradeci) from *mason* (Fr. *maçon* “stone-mason”); *gaç* (Fishta) “donkey” from **gar-ç*, being associated with *agër* and *gare* (Buzuku); *gomën* (Fishta) from Sl. *głobina*; *I errmaktë* (Mjedja) “left” from Lat. *mancus* “maimed, lame”; *i riçëm* (R. Siliqi), from the participle *ritë* of the verb *rîj* with the suffix *-shëm*; *i shushulluar* (Poradeci) from an onomatopoeia (*shu-shu*); *jétullëz* (De Rada) and *hjetull* (Giordano) from *fjetull* (It. *fetta* + *-ull*); *kanísk* (N. Frashëri) from Mod. Gr. *κάνισκι*; *klind* (Asdreni) from Lat. *clino*; *mbroth* (S. Frashëri) from Lat., It. *prode* “benefit”; *men* (Mjedja) from It. *meno*; *murgjinë* (Mjedja) from the plural *murgj* + *-inë*; *ndoset* “entirely, wholly” (Fishta), from the ablative case of the name *dosë* with the prefix *n-*; *pekúl* (N. Frashëri) “care” from Lat. *peculium* “special property”; *rakitë* (Poradeci), from Sl. *rakita* “willow”; *rmajt* (Fishta) “grave”, the plural of *romanj* (*roman* + *-i*); *rrêj* (Migjeni) from IE. **ren-*; *shporr* (Asdreni) from *sh-* + IE. *b^her-*; *shqim* (Mjedja) and *shkim* (Fishta) from *shqyej* and *shkyej* (*shqye* + *-m*); *travajë* (Mjedja) from it. *travaglio*; *trirë* (Kuteli), from Lat., It. *trîna*; *vdjerr* (Asdren) by *bjerr* “lose”; *vome* (Çajupi) from *vaj*; *zdrale* (Migjeni) from *z-* + **dra-* + *-lë* being connected to *zdramë*; *zgaq* (Mjedja) from *z-* + *gaqe*; *zgerbonjë* (Kuteli) from *zgarbë* + *-onjë*.

